



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 168, Datë 26.08.2024**

**MBI**

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “SUN’S MIRACLE” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a” dhe 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.08.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1652/9 prot., datë 22.08.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë “SUN’S MIRACLE” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “SUN’S MIRACLE” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1652 prot., datë 17.07.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2MW dhe veprave ndihmëse, në Zonën Kadastrale Nr. 3358, Fshati Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 150, datë 25.07.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e kësaj shoqërie, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës (në datat 26.07.2024 dhe 27.07.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 05.08.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën me nr. 1652/3 prot., datë 29.07.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo të plotësuar pjesërisht.

- ERE me shkresën nr. 1652/4 prot., datë 29.07.2024 ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) mbi fillimin e procedurës së licencimit të kësaj shoqërie në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria me shkresën me nr. 1652/5 prot., datë 07.08.2024, ka përcjellë një pjesë të dokumentacionit plotësues të aplikimit. Në vijim, ERE nëpërmjet shkresës nr. 1652/6 prot., datë 16.08.2024 dhe e-mailit, protokolluar me nr. 1652/7 prot., datë 16.08.2024, i ka bërë me dije subjektit se duhet të saktësojë një pjesë të dokumentacionit dhe ta përcjellë atë në ERE. Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1652/8 prot., datë 21.08.2024 ka depozituar sqarimet/ saktësimet e kërkuara nga ERE.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A, të Rregullores së licencimit.
- Nga analizimi i aplikimit, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9 të Rregullores, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 gërmat “a”, “b” dhe “c” dhe për pikën 2.1 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “SUN’S MIRACLE” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2MW, për një afat 30-vjeçar.
2. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, jo më vonë se data 15.09.2024.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “SUN’S MIRACLE” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**